

VENDIM
Nr. 159, datë 30.12.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 40, DATË 1.6.2018, “PËR LICENCIMIN E
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TROPOJË”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 40, datë 1.06.2018 ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tropojë (UK Tropojë), me shkresën nr. 104 prot., datë 28.9.2020, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjorë dhe drejtuesit teknikë të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Tropojë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Tropojë për herë të fundit me vendimin nr. 40, datë 1.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Tropojë sh.a., z. Bajram Gjongecaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi, në vitin 1981, me titull “Ekonomist për industrinë”.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Tropojë sh.a., z. Visard Byberi, ka mbaruar studimet e larta master profesional në “Inxhinieri Hidroteknike”, në vitin 2018.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tropojë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Tropojë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 40, datë 1.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: Bajram Gjongecaj”;

“Drejtues teknik: Visard Byberi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani